



SHIKOJ.COM

RETE E LINDOJES

PUBLICISTIKA DHE LETËRKËMBIMI

**Përkthyer
nga**

JUP KASTRATI

RETË E LINDJES

Sukseset e fundit në Lindje zbuluan shkakun përse nuk dukeshin dhe nuk thuheshin pengesat që i viheshin paqës së dëshiruar në atë pjesë të Evropës që ka nevojë për qetësi dhe përse Evropa nuk mund të ishte e qetë dhe e shkujdesur për shkak të gjendjes së pasigurt atje.

U pa si drita e diellit se ishte vetë Rusia që nuk donte të lëshonte nga dora plaçkën që pat marrë nga Turqia, e cila i qe lënë ndër dhëmbë me paqën e Shën Stefanit, por që Evropa ndërhyri dhe ia rrëmbeu. Dhe ja që ajo as vetë nuk rri, as të tjerët nuk i lë të qetë, gjersa ta marrë përsëri atë plaçkë nga duart e kësaj. Dhe, siç më duket, sot ajo lakmon edhe diçka tjetër. Gazeta «Moskovskaja Vedemosti» e 3 shtatorit e tna haptas: «Princi Aleksandër duhet ta mbajë fjalën e dhënë. Ai duhet të vërë në duart e Carit – siç premtoi kur e mori – kurorën e Bullgarisë, që vetë Cari i madh i Ruisë ia dha».

Në pritje të çastit për t'i hequr Turqisë një copë më të madhe, dhe kështu të zmadhojë perandorinë e saj, Rusia punoi tinëz, me qëllim që Rumelia të bashkohej me Bullgarinë. Veçse ato dy krahina, krenare dhe të kënaqura për bashkimin e tyre, ndryshe nga ç'priste Rusia, menduan dhe deshën të jenë më vete. Dhe për

këtë faj ne pamë mbretin e tyre të kapet rob prej shërbëtorëve të Ruisë dhe të «ekspozohet si në një panair».

Evropa, si një trumë zogjsh të trembur, deri tashti nuk ka bërë tjetër veçse zë në erë (zhurmë në ajër).

Turqia, e braktisur, rri si e mpitë.

Austria dron se mos, në çastin e nevojshëm, Gjermania nuk do t'i jetë në krah.

Dhe vetë ajo (Gjermania) gjendet ndërmjet dy shpatave. Franca, që armatohet dhe përgatitet për të rifilluar dyluftimin, i sjell në buzë një fjalë që ia tharton grykën: «Ajo në Ballkan nuk ka çka kërkon». E lë, pra, Rusinë të jetë arrogante dhe aspak e shqetësuar të kalojë me Francën, nga e cila përkëdhelet. Nga qëndrimi i Francës, dikur, nga lufta e Krimesë humbi frytet e veta dhe tash pret të prishen paktet e Berlinit. E dielli i Gjermanisë duket sikur zbehet pranë saj dhe ka për t'u penduar që atë e ka përkëdhelur vazhdimisht.

Kështu, mua më duket se ajo u gënjye (gaboi), duke vënë, me hir të Ruisë, këmbën te zverku i anës së Polonisë, aneksuar Prusisë, sepse në këtë mënyrë ka forcuar sundimin e rivales mbi pjesën më të madhe të atij kombi fatkeq; dhe i la Francës të shpresojë ta ketë me vete në kryengritjen që aq tepër dëshiron. Ndërkaq, askush nuk do sot të bashkohet me kushtet e Francës, dhe në qoftë se Pozeni, sikurse Krakovia, të thithte atje ajrin e lirë të stërgjyshërve, pjesa tjetër e Polonisë do t'i rrinte Ruisë «si një armë e re në një veshje të vjetër».

Mbetet Anglia që, nëse lordët e saj do të merrnin në dorë drejtimin e vendit, do të mund të shuante turbullimet në Evropë, që sot, sa vjen e më tepër, deh mendjet e njerëzve duke i dhënë Austrisë, si edhe Gjermanisë, një përkrahje të fortë e të vendosur. Pas kësaj njerëzit

e krishterë do të ngroheshin rishtaz, nga feja e tyre e lashtë, me rastin e fitores së drejtësisë. Por në Angli ata që edhe pa gjë, u premtajnë gjetkë gjithë të mirat kom-beve që t'i zgjedhin përfaqësuesit e vetvetes, edhe në Angli venë duke pasur ndër duar shtetin. E pse figu-rojnë ata më tepër me dinakëri dhe me ambicje që ndje-kin njëra-tjetrën, si gjithkund, zotërimi është bërë i luejt-shëm, vazhdimisht sipas dëshirave. E, megjithatë, sot kjo duket se po u besohet lordëve, me zërin e të cilëve merr frymë Anglia plakë, ndër duar të të cilëve nuk çahen paktet. Gjermania mbahet sepse nuk guxon t'i be-sojë. Por në paralizimin e Fuqive të Mëdha kjo, për sa i takon pjesës së vet, paguan, sepse duket tashmë që janë pikërisht këto që nuk e lënë Evropën të prëhet (të rrijë) e qetë me kujdeset e vetvetes. Evropa e mjerë rri e brengosur vazhdimisht, sepse do të mbytet në gjak për të mbajtur dhe për të mbrojtur djemtë e saj në ushtri, «ushtri dhe burgim». Sot kjo i flijoj (i bëri fli), the-mi djallit të botës Aleksandrin e pafuqishëm.

15 tetor 1886

NJË MEMORANDUM

Gustav Majeri thotë për shqiptarët e sotëm, siç vërtetohet prej tij nga një memorandum: «Që bashkimi i Shqipërisë me Monarkinë Austro-Hungareze ishte konsideruar në mendjen e tyre si një gjendje kalimtare. Austria duhet t'u japë atyre (shqiptarëve) të mirat e kulturës, e, kur të ketë kryer punën e saj, duhet të shkojë (të largohet nga Shqipëria), Është e vështirë pra, që misioni ynë, duhet të konsistojë në bërjen, përgatitjen e mësuesve të shkollave të përkohshme për kombet e huaja, derisa këto dalin jashtë tutelës». (Shih: «Arbëri i Ri, viti I, nr. 2).

Kush janë këta që i lypin ndihmë Austrisë e ku? E me çfarë projekti profesori i Gracit merr përsipër vendet e kësaj e, me një paganizëm dorështrënguar, i lejon ata?

Disa gazeta të Parisit, kur doli *Fjamuri Arbërit*, lajmëronin Italinë që të lakmonte Shqipërinë e, për ta tërhequr këtë, të themelonte ndër ngulimet tona arbëreshe një gazetë shqip. Por ne nuk dinim gjë për ambiciet e Italisë, as kjo nuk e ndihmoi kurrë organin në fjalë, që qe vetëm i mëmëdheut dhe i ngulimeve arbëreshe. Edhe sikur të na falnin tërë botën, ne nuk u shërbejmë ineresave të huaja në dëm të kombit tonë, bij të të cilit jemi.

Është e vërtetë se Shqipëria kur qe ngushtë, nuk iu drejtua as Austrisë, as Italisë, as kërrkujt tjetër, armë e të cilëve t'ia ndërronin samarin; madje as popullit të saj të shumtë që ka mbetur nën Greqinë dhe të cilit sharlatanizmi grek ia ka bërë shpirtin budalla. Ajo (Shqipëria) u drejtohet e u kërkon ndihmë bijve të vet që janë të shpërndarë nëpër Rumani, nëpër Egjipt etj., që të ngrenë kryet e më tepër mbi të gjitha kryesisht ka besim e shpreson ndër ngulimet e veta arbëreshe të Italisë. Këto kanë këtu dy kolegje, e ai i Shën Adrianit, në veçanti, i hapur me këtë shënim: «Në të do të mësojnë (do të rriten) djem dhe të rinj prej Shqipërisë, por edhe nga mbretëri të parashikuara për tokat përkëtej Farit të Lindjes».

Tani që asnjëri nuk i mbetet për të parë, e qoftë edhe në Itali – kurrnjë fener ndriçues që rrezaton prej së largu një popullsi të pikëlluar, çfarë kanë për të parë, në qoftë se mbledhin ndër shkollat tona bijtë e Nënës sonë të paharrueshme Shqipëri, e cila nuk ka shkolla? Apo do të kenë «syrin e keq për atë që Italia do të jetë e mirë» me ne, të cilët i ushqen toka e saj, qielli i saj dhe mendimi i saj e, së bashku me të, të ndihmojë ndër këto kolegje mësimin e katedrës shqipe të krahasuar, mbrojtëse e një populli, të cilin ajo e strehoi me mundime të mëdha dhe s'e pat ndarë, pastaj, kurrë nga fatet e veta? Ajo nuk bën gjë tjetër veçse ta ngrejë mbi themelet e gjuhës amtare Shqipërinë. Nuk bën tjetër veçse t'i nxjerrë në pah vetes, në mënyrë fisnike, nderin për të rindërtuar – dhe vetëm ajo mundet – gjuhën shqipe, që është një nga më të moçmet gjuhë evropiane. Kjo është e mirë dhe e denjë për të.

15 gusht 1887

RAFAEL XAGAREZËS

Sot në perëndim të diellit, po shëtisja me Antonin dhe me Engjëllin kundrejt mureve të Shën Adrianit. Rrinim në heshtje duke menduar se mbas pak ditësh nuk do të takoheshim më në atë rrugë, dhe dëgjuam, me një melodi mallëngjyese, si ideja e amëshimit në njeriun kalimtar, të këndohej një nga ato, që ne i quajmë vargje, të cilat shprehin gjithnjë një ndjenjë të vetme e të zjarrtë, Po ta përshkruaj që ti të shohësh shijen e këtij populli.

*«Mos më harro, o djalosh, në udhëtimin tënd,
sepse, sa të desha, as vetë s'e di.*

*Mos më harro, kështu që të mundesh, kur të
kthehesh,
të më gjesh të bukur e të re, siçë m le».*

Zëri e kujtimet e dimrit të kaluar më shkrehën në vaj. Unë e ndieja se jeta ishte bërë më e pasur e kishte nevojë të zbrazej në dikë. Kudo që kaloja, bëheshin lutje që nisja ime për në Napoli t'i sillte dobi vendit. Kush i zatet këta njerëz të pakënaqur dhe u heq fuqinë dhe i bën të jetojnë me shpresë në të tjerët? Këto mendime më trullosin: unë e lë veten në dorë të fatit, pa u menduar, sikur ai që hidhet në jetë vetëm për shastime të

forta. Oh, sa më ka ndërruar ky vit! Në korrik të vitit 1833, duke e pasur kokën plot me numra e me shpresa, dola nga kolegji. Toka më buzëqeshte ngado që unë e vështroja; derdhja në këngën e dytë të veprës *Kruetani i mërguar*, me vargjet që ndjekin, ndjenjat me të cilat më mbushte atdheu im:

«Unë po shtrihesha edhe një herë në shtrat,
të cilin dadoja ma kishte mbushur,
e gëzueshme që po më shihte rishtas; dhe ishin të
gëzuara vatrat, shtëpiat për të korrat. E zhytur
në mendime të thella, e hutuar, shkëlqente hëna
dhe dukej tamam si ditë e gjallë, rreth lumenjve,
që të rrethojnë, o Maqë. Nëpër kallëza,
zihatja e lehtë e bujqve të vatrës e mbushte
ajrin e qetë dhe fushat e larueshme. E lodhur,
vasha flinte, duke ëndërruar agimin
dhe shoqet kah mbushnin boskat
për vjelësit, ndërsa ajo në fundin
e errët të tremes, dorë për dorë, kapet
me të birin bujar të zotit të arës.

Dhe prej vetë atij vendi, herët,
si ta kishte zgjuar Xagareze,
do ta thërriste në shtëpi dhe në flladin jashtëzakon sht
të melodishëm të natës, i rrëmbyer, do të shikonte
pas nga Maqi, i mbështjellur nga kodrat e djegura
dhe nga pyjet që merrnin avullim,
Më dukej se kurrë s'do të merrte fund jeta
ime këtu në tokë».

Në ato ditë të bukura më lindi në zemër kënga që
fillon *Ljis jeta kish ndërruar*. Trajtat e saj tepër të gjalla

dhe të zhveshura nga çdo pikëllim më bindën se unë isha mjaft i qetë për të shkruar, plot gazmend, sipas poetit të Teos. Ecja nëpër pyje, nëpër brigje të lumenjve dhe nëpër vërrija me tronditje të ëmbla. Unë ngjitesha kodrinave dhe një mendim lavdie më dehte. Shpesh, ndër ditët e kthjellta të asaj vjeshte, rrija në bregun lindor të fshatit. Veriu (tramundana) lëkundte, përposhtë meje degët e zbardhemëta të ullinjve dhe e gjithë sipërfaqja e kaltër e detit po shkumëzonte. Ajo anë e tokës, e braktisur në tronditje e në fishkullim, më sillte ndër mend rrëmujën e sa brezave njerëzorë. Po ende nuk kishte filluar të acarohet dimri, kur të endurit tim ishte më i lirë të bariste. Unë ndieja si thellësisht e kisha shprehur atë që këndoi Italinë «se dashuria, kur është një passion, të çon gjithnjë në mallëngjim».

Do të kishte qenë pa vlerë sikur të bashkoja këngët popullore shqipe, mbasi do të bëhej një përmbledhje, e cila, tash, është plotësuar dhe vënë në vargje italiane nga miku im fisnik Engjëll Bazile dhe meqë m'u dukën disa shumë të këndshme, ua mësova të rinjve fshatarë. U përpoqa të hartoj ndonjë në mënyrën e atyre dhe nuk më dolën fort keq, ndërsa secilën këngë të re, që këndohej për të parën herë në mbrëmje, gratë dilnin ta dëgjonin ndër dritare. Kjo më nxiti dhe më lindi ideja për romanin tim dyfish lirik. Në të derdha shumë ëmbëlsi e mallëngjim, sidomos vërtetësi, duke përshkruar në të, në pjesën më të madhe, ngjarje krejt të mia: as kam lexuar ndonjë gjë aso dore. Është lehtë veç që të gjendet një shembull i tillë, meqenëse këto vise shohin pak libra. Tash po e shoh se ky vit më ka kalur kot, si kalorësve endacakë në kështjellën e Atlantit; s'kam bërë asgjë për të ardhmen, që të ndiej më tepër kënaqësi për

të. Në fund të muajit këto vise do të më mbyllen si përgjithmonë. Ndoshta, kur të kthehem, do të dëgjoj gjatë të vjelave dhe gjatë të korrave këngët e rinisë sime të parë dhe duka e ndier veten gati si të huaj, do të them me vetvete: A nuk janë këta të rinjtë, a nuk janë këto gratë, me të cilat kam ndenjur aq herë në tryezë, në fushë dhe kam festuar të kremtet? A nuk është kjo fytyra ime ajo e mëparshmja?

Po i jap fund, lum miku, se pak më vlejné këto ëndërrime; vetëm, të lutem, eja shpejt të më takosh e të më gëzosh. Lamtumirë!

Maqë, më 20 tetor 1834

Mikut yt

Jeronim De Rada

MIKEL DE RADËS

Ju ndieni për mua kaq dhimbje të madhe, sa që edhe unë vuaj ashtu sikur unë të mos kisha fuqinë e duhur t'i bëj ballë, jo vetëm vetmisë, por edhe të këqijave më të mëdha.

Në qoftë se u vini vesh fjalëve të botës, nuk mund të kuptoni ndjesitë e mia. Ju lutem, kujtohuni si u mbështeta në të gjitha vështirësitë e jetës sime, në perëndinë dhe në fatin tim.

Edhe mua, në këtë heshtje, më paraqiten, në një inënyrë të errët, të gjitha ato mendime që lakmia për të mirën m'i ndriçonte më parë; megjithatë, unë i vlerësoj dhe përpiqem vazhdimisht për t'ua zbutur atë vrazhdësi që vjen nga lodhja.

Dhe në pak ditë, krava (përveç legjendës së *Hunias* në librin IV të *Epopesë*) edhe shtesat për *Këngën e Milosaos* dhe pothuajse, as që duket, në paraqitjen e kthjellët të vet, pikëllimi i shpirtit tim.

Ashtu siç është tash, më pëlqen. Porsa zgjohem në mëngjes, duke parë se si po më ikën një ditë shumë e kthjellët pa bërë gjë, ngushëllohem me këto këngë, duke ia lënë kohës, kur nuk kam për të ekzistuar më në asnjë vend të botës.

Dje u shqetësova shumë, mbasi nuk kisha lajme për
tim vëlla. E marr me mend që do të jetë shqetësuar nga
largimi juaj. Qëndrojini afër me këshilla dhe, këso dore,
nga kjo fatkeqësi do të fitojë shprehi për punë dhe do
të tragohet i matur e i vendosur.

Me shëndet jam krejt mirë.

Ju kërkoj bekimin dhe mbetem

Biri juaj shumë i dëgjueshëm:

Jeronimi

Napoli, më 20 shtator 1839

VINÇENC DORSËS

Kam lexuar me kënaqësi të madhe *Letrat e tua romane*, sepse më kanë bindur plotësisht për gjithë mbështetjen e madhe që mund t'u sjellë mendja juaj e mprehtë ngulimeve tona. Çka, në të vërtetë, më ka goditur fort në to, është mënyra e drejtë me të cilën hulumtoni në lashtësinë e madhe latine. Gjykimet tuaj të qartë, të mendjes suaj të mprehtë e konsekuente s'i shpëton as letërsia, as doket, as feja dhe, me fjalën tuaj, jeta e anasve të Italisë ndihet se jeton ende në historinë e Romës, tek e cila popujt e mundur ishin mësuar të shikonin vetëm forcën fitimtare. I keni përvijuar me siguri të plotë edhe kufijtë e trevave pellazge. Gjithashtu keni prekur edhe fjalën *Vesta* në të gjitha vështrimet, ia keni zbuluar kuptimin e vërtetë në heksametrin e Ovidit *Nec tu aliud Vestam quam vivam intellige flammam*, por vetëm s'ju kujtua fjala shqipe *Dhesta* (gjithnjë e ndezur), nga e cila rrodhi *Vesta* dhe *Ifestos* (Hefesit) helen. Por, tashti, si një tis i dobët, ajo magji e kështjellës së Atlantit, ajo asgjë që ndërvihej mes nesh e popullit pellazg, ka rënë dhe është zhdukur. Dhe tash nga Frashinetoja, vendlindja e Dorsës, ku njihen aq shumë gjuha e kultura helenike, pritët më fort se nga ngulimet e tjera vënia në pah (qitja në dritë) e lashtësisë së popullit tonë.

Nuk dua ta përfundoj këtë letër pa ju dhënë një sihariq.

Kur vitin e kaluar Tomazo Paçe që në Athinë, botoi në gazetën *Minerva* disa mendime të veta mbi kombin (popullin) pellazg, mbi lëvizjen mendore të ngulimeve të Siqelisë dhe mbi bukurinë e fatet e gjuhës shqipe. Kështu dje ai mori një pliko (pako) me libra shqip nga Bukureshti në Vllahi, dhe një letër nga një zotëri shqiptar, Qiriako Danjeli, në të cilën i thuhej:

«Lajmi se në Itali lëvrohet gjuha jonë na ka bërë zemrën të gufojë nga gëzimi këtu në Shqipëri». Ndaj i kërkonte nga një kopje të të gjitha gjërave të botuara te ne që t'i çoheshin (dërgoheshin në Brailov (Brëillë). Bëjeni të ditur për këtë Ç Santorin me qëllim që t'i bëjë një rishikim të mirë dramës së vet dhe ta përgatisë për ta nxjerrë në dritë. Unë basoj se e keni lexuar *Këngëtoren* e tij të vogël dhe, sikurse dhe unë, keni vërejtur në të vulën (tiparet) e një poeti të thjeshtë e të fuqishëm: fjala buron e gjallë dhe me një mënyrë të re nga shpirti i tij; përfytyrimet e tij janë marrë nga jeta shqiptare, me më tepër vërtetësi se sa ato të Gesnerit nga jeta zvicerane dhe, nëse nuk e ka figurën hyjnore të Laurës dhe trillimin e shumëllojshëm, të pastër e të stërhollë të këngëtorit të saj, prapëseprapë ka një dashuri më të trishtë (të zyrtë) e më të vërtetësishme.

Jeronim de Rada

Napoli, 1847

SANTORI IM

Mbrëmë i mora dy këngët popullore që më dërguat: *Shkoi një trim nga një rrugë dhe Ajo zonjë e reja e Gjikes*. Kjo e fundit, për përmbledhjen time, sot është një dhuratë e çmueshme, sot që një bijë e Gjikalje shqiptarë, lindur në princat rumunë, Dora d'Istria (princesha Kolcof Masalsky), po tërheq mbi vete sh'kimet plot simpati të Evropës së kulturuar. E kanë quajtur Stael i Veriut; e barazojnë me Korinën.

Për çka kam lexuar unë prej shkrimeve të saj (ashtu sikur figura e parë romantike, që më tronditi krejt shpirtin tim në moshën katërmëdhjetëvjeçare, qe Korina), tek Elena Gjika më duket si tipar dallues i veçantë një arsyetim prej burri, kështu që ajo veçohet nga vetë natyra e seksit të vet që sundohet, gjithnjë, nga burri dhe e lirë i përmbahet dijes, ashtu sikur i përmbahej zotit të vet Shën Terezja, me të cilën ka një ngjasim në shpirtin e ëmbël dhe të kthjellët dhe në vëzhgimin praktik të pasosur. Madje, për nga harmonia aq e plotë e përsosmërive dhe e bukurisë së trupit me vetitë e jashtëzakonshme që vërehen në të, mua kjo më sjell ndër mend një tjetër grua, shqiptare edhe ajo, që, e lindur në Egjipt, bëri për vete më parë Çezarin dhe, pas tij Antonin; porse kjo ndryshon nga Kleopatra, ngase ajo mbretëreshë, e drej-

toi mendjen në edukimin e vetvetes, pothuaj si një lule kalimtare, që të marr sytë me ndriçimin e saj dhe që, pastaj, s'i qëndroi stuhisë, nga e cila gjë u shkatërrua mbretëria e të parëve të saj.

Përkundrazi, kjo princeshë trime (heroike) dhe me cipë, duke mos u larguar nga Krishti, mund të thuhet se është agimi i popullit të vet.

Gjyshërit e saj, Gjikajt fisnikë, të dalë nga Shqipëria dhe të ngritur në rangun e princave rumunë në vitin 1658, duke sunduar për afro dy shekuj, brumosën (formuan) shpirtrat dhe fatin e principatave, duke i bërë të aftë për të siguruar shtetin e tanishëm dhe, ndofta, edhe një tjetër më të madh, ashtu sikur Qyprilitë, bashkatdhetarë me ta, rimëkëmbin nga ajo kohë fatet e Perandorisë osmane, që ishte në tatëpjetë.

Dhe, për tash, atdhetarët shqiptarë nuk shohin ndonjë zgjidhje më të mirë se kjo; t'i krijojnë vendit të vet një stabilitet të kënaqshëm.

Sepse revolucioni, i këshilluar nga të jashmit, dhe marrëveshja që synonte ta nxirrte më vetë, do ta linte pa mbrojtje kundrejt Turqisë e aleatëve të saj. Dhe tashti dihet se, duke përdorur në përgjithësi njerëz që nuk kanë gjë mbas shpirtit, që fusin hundët e përzihen aty me qëllim që të përfitojnë, më vonë, në kurriz të të tjerëve, shfrytëzon, në mënyrë të turpshme, vetveten.

Kjo masë dashamirëse do t'i jepte njëkohësisht fund rrezikut që Turqia, nesër ose pasnesër, të shihte të drejtuar kundër saj këto shpata (armë) të trimave që e mbështesin, por që, megjithëse pak, ia shkëputën Greqinë (d.m.th: e çliruan Greqinë) me Boçarin, Miaulin, Xhave-lën, Tombazin, Makrin, Gurën, Niçetën.

Por le të ngjasë ashtu siç është shkruar atje lart. Le

të marrim zemër nga figurat e mëdha të këtyre bashk-atdhetarëve tanë, dhe të mos braktisin vendin që perëndia, së bashku, na ka caktuar për rimëkëmbjen e atdheut tonë të shpërndarë.

Për pjesën tjetër (tepricën) mbani, ju lutem, qetësinë që ju sjell çdo ditë. Në vitet që na mbeten (mbesin,) mbas kaq viteve që kaluan dhe që duhet të ishin më të mira, nuk ka hije për ne që të kërkojmë ndonjë gjë tjetër. Edhe për ju janë dy arsye që të siguroni një paqe në trazirat e tanishme. E para, se deri tashti një dorë, gati si nga jashtë, i ka mbajtur në mes kaq britmash kundërshtare këto ngulimet tuaja, të cilat, megjithëse janë krejt njerëzore, në to duken shenjat e lirisë që njeriu përdori në kërkimin e zotit, kaq fort e tërheq atë. E dyta, se ju, duke u larguar nga shekulli (nga bota) jeni çliruar edhe nga ato që duken të mirat e tij dhe që tash kërcënon t'ua heqë. Fyerjet që i drejtohen Krishtit, pastaj, tanë nuk e prekin më siç e preknin kur ishte në kryq dhe popullit të ri që e rrethon, duke e sharë, i ngelet një boshllëk nga pakënaqësia. Por nuk jeni vetëm ju në hall; krejt Italia është në këtë gjendje. Edhe Principata e tij është ngushtë. Ndërkaq, revolucioni i ka aneksuar së bashku me provincat, duke i shpërndarë nëpër ushtritë gjithë oficerët e përgatitur ndër sekte dhe që punojnë për t'u shërbyer atyre, duke krijuar kështu parazitë të panumërt për shtetin, që po e përpijnë gjatë rrugës. Por, dhashtë zoti, që ai, duke pasë përkrahjen e vendit, që po pëson gjithë këtë të keqe, ta kuptojë situatën. Kjo shpresë ne na mban.

J. de Rada

3 prill 1865

Letër Anton Santorit

SHUMË I DASHUR IM' KAMARDË

Po ju përgjigjem menjëherë, mbasi nuk më kanë mbërritur ende të gjashtë kopjet e librit tuaj dhe as ndonjë letër para suajës, bashkë me tjetrën drejtuar zotni Jenos Koronejt. Mora vetëm një kopje, dërguar në emrin tim dhe jam duke e lexuar copa-copa, mbasi jam zhytur në punë fushore dhe në përgatitjen e dorëshkrimit të këngëve kombëtare dhe të arsimimit të tre bijve të mi. etj. Dhe ja, tashti, mbresa e çiltër që kam për të.

Libri është i çmueshëm për një mijë shfaqjet (dukuritë) që tregojnë mendjempreshtësi të veçantë. Por, shpesh, ju pushton (zotëron) ideja e gabuar se gjoja (pra) shqipja është, thuajse, një dialekt helenik dhe (kjo) ju shpie në dy të meta: 1) të shihen marrëdhënie ku nuk ka o ka me fjalë jo shqipe, por të marra prej nesh andej-këndej; 2) të pranoni si forma të rregullta foljesh solecizmat dhe shtrembërimet gjuhësore. Për shembull, ju e ndërtoni (sajoni) në bazë të së tashmes e të së shkuarës pohore foljen me puthë, duke e zgjedhuar jo siç duhet.

Në radhë të parë, puthë është veta e dytë e urdhërores e dalluar qartë nga e para e pohores puthinj dhe kjo zgjedhohet kështu:

puthinj
puthën

putha
puthe

puthën	puthi
puthëmi	puthëtim
puthëni	puthëtit
puthënjën	puthëtin

Ky fakt do të jetë ai i gjenisë krijuese që do të vijë, siç e uroni; ndërsa e di që është ajo e ngulimeve tona, përzier me gegë e epirotë (toskë) ose shqipe e vërtetë, shtrembëruar paturpësisht nga Da Leçe e nga për-kthyesi i ungjive; për të tjerët nuk di.

Ju veç gjithnjë jeni i pari shqiptar që sillni dritë në skajet më të hershme të gjuhës dhe ju jemi mirënjohës për këtë. Të shoqëruarit e Shën Kozmos janë përfshirë në gjashtë kopjet e mia. Lamtumirë!

Shumë i dashur miky yt
Jeronim de Rada

P. S.

Jepjani letrën e përfshirë këtu brenda zonjës princeshë Dora d'Istries.

Njëzet ditë pas korrjes, do t'ju dërgoj një ose dy përralla e letër.

21 qershor 1865

Letër Dhimitër Kamardës

SHUMË I DASHURI IM, KAMARDË

Të gjashtë kopjet që më keni dërguar kishin ngelur në Koriljano, nga refuzimi i korrierëve këmbësorë për t'i sjellë, sepse janë dymbëdhjetë milje rrugë, sado që unë pata folur (ngulmuar); megjithatë, është gjë që mund të ndreqet. Për të tri të dërguarat Stamiles, nuk di ende kurrgjë, por do të interesohem për t'ju njoftuar për to. Shpresoj se, përveç të gjashtave, të nxjerr edhe dy të tjera.

Duke u kthyer, tashti, në argumentin që ju pëlqen, ju them se unë kam disa ide fikse, që janë si fener (dritë) i gjykimeve të mia.

Një nga këto është se, kur vërej që gjuha ka forma të ndryshme, të sakta e të rregullta në zgjedhime e lakime (siç i ka shqipja ndër ne) dhe e shoh të njëjtën gjuhë të shkruar o të folur, jo më me ato forma, por me disa që i ka humbur, e me pak të mbetura, i zëvendëson të gjitha e i përziën, mendoj se në këto është prishur. Shpresoj pastaj se bota nuk do të më pandehë si pretencioz mua që, prej 30 vjetësh, merrem me gjuhën time, nëse kam marrë parasysh shumë Da Leçen e peshkopin e Korfuzit; as sepse u linda shqiptar e mblodha këngë të lashta, sa të mund ta quaj veten më pak të ditur në gjuhën time, se sa ç'është Hahni.

Më është ngulitur, gjithashtu, ideja që të mos besoj se mëmëdheu e flet gjithnjë më mirë se ngulimet arbëreshe gjuhën e vet dhe se duhet ta ruajë më mirë edhe karakterin, edhe fenë etj. Atdheu mbeti nën të huajtë, që e shkelën dhe e prishën. Ne u strehuam në vende të veçuara dhe shpëtuam. Pastaj, mëmëdheu nuk na flet, tashmë, ai ne; por, për të, njerëz të huaj na bëjnë të flasin fjalët e tij. Së fundi, Homeri, që themeloi kulturën greke, kishte lindur në një nga kolonitë. Dhe kjo do të ngjasë edhe për Shqipërinë, dhe ju vetë, Kamardë, filluat ta bëni.

Kam edhe një ide të tretë, që më është ngulitur, se tek gjuhëtarët e gramatikanët nuk është mirë të mbështetemi, por ta deshifrojmë një gjuhë. Kështu, ndër 24 ngulimet arbëreshe të Kalabrisë është ligj i qëndrueshëm të vihet t-ja në veten e parë shumës të së shkuarës së foljeve që mbarojnë me një, qoftë kur kanë theksat ('ed) në rrokjen e para fundit, qoftë kur kanë theksin cirkonfleks mbi të parafundit.

Si: derdhinje, e shkuar derdha, shumës, derdhtim derdhëm
 puthinje « putha « puthtim—puthëm
 dëthinje « dëthita « dëthitim —thëthitëm
 shtinje « shtita « shtitim—shtimë

por nuk e kanë në të njëjtën vetë foljet që sosin në nje, të paraprirë nga zanore e theksuar:

çjonj/ çonj — gjej/ e shkuar çjova — /çova — gjeta/
 shumës:

çjuam/ çuam — gjetëm

rrëmpenj /rrëmbenj, marr / e shkuar rrëmpeva/ — rrëmbeva/
 shumës: rrëmpiem/ — rrëmbyem/.

Dhe të tilla ndërrime shtrihen me një rregull të përpiktë në zgjedhimet e tjera, në ato me mbaresë në eghë: *dieg/ -djeg/* e shkuar *dogja*, shumës: *dogjëtim/ - dogjëm*.

Ato që mbarojnë në asë:

shkasë/- *shkas*, *shqas*, *përshqas/*, e shkuar;

shkava, shumës: *shkam/ - shkamë*, *shqitëm/*

Fjas/ - flas/ paraqet një parregullsi, nëse e bën të shkuarën e rregullt *fjava/ - fola/*, në shumës bën *fjami/ - folëm - pat*; nëse merr *folja/ - fola/* (pothuajse nga *foljinjë*) nga *foljë tin me t/ - folën/*.

Kam hartuar një gramatikë të vogël dhe nga pasqyra e zgjedhimit, ku janë shënuar rregullisht këto gjëra, i rrok me një të hedhur syri.

Por, po të doni, zereni sikur nuk është thënë asgjë për këtë. Ju më urdhëruat që t'ju thosha përshtypjen që më pat bërë punimi juaj i ditur. Dhe e thashë me çiltërsi. Pastaj u shtriva shumë, sepse m'u duk se juve ju kujtohet vetëm se unë një shqiptar dhe jo ai shqiptari që prej më se 30 vjetësh përpiket ta ngrejë gjuhën tonë për të shprehur konceptet e qytetërimit të sotëm. Duke folur me guxim, nuk besoj të kem folur me mendjehetësi për këtë çështje.

Këngët kombëtare do të shikohen në Firenze, në botat e tyre, shpresoj nga një shqiptar. Dhe vetë radhitjet e tyre, edhe do të kem mundësi t'i qorto, duke iu kush-tuar vëmendjen e duhur.

Ju përqafoj, shërbyesi juaj shumë i dashur,

Jeronim de Rada

25 qershor 1865

Letër Dhimitër Kamardës

I DASHURI IM, KAMARDË

Kam marrë me shumë kënaqësi shkrimet tuaja. Po ju shti (fus) këtu brenda një çek 3.50 d., çmim i pesë kopjeve të librit tuaj e gjashta m'u kthye duke më kërkuar të falur. Ia kam dërguar dikujt tjetër. Shpresoj ta ketë pranuar. Shkurt, është varfëri e madhe, nga e cila prej pesë kopjeve nuk mora ende vlerën, por do ta marr më vonë.

Droja se mos nuk ju ka arritur *përrallëza*. Do t'ju dërgoj një seri (që jam duke i dëgjuar në këtë krishtlindje), nëse do të kem mundësi t'i kopjoj.

Për botimin e këngëve, unë po çmendem. Më erdhën bocat e librit të parë e të një pjese të së dytit. Dhe, mbas një pritjeje prej dy muajsh, m'i dërguan pardje bocat, mbasi një bashkatdhetar yni që i pat, i kish kaluar në shtypshkronjë. Më duket si rrëmbimi i Lekës. Siç keni mundur t'i shikoni, janë me të vërtet të bukura. Sa për mua, e përsëris, mendoj se në poezinë e sotme ato do të duken ashtu siç u duk Skënderbeu mes princërve bashkërkohës me të. Ju më nxitni që të kthej mbi /çështje/ të gjuhësisë. Por ajo që vëreni në të *meje*, meriton një sqarim. *Të-ja* nuk është aspak një nyjë në vështrimin e ngushtë të fjalës, që ju ia vishni. Kemi fjalën të *motërën*, të *motërat*, etj., ku *të-ja* do të jetë një nyjë e

vërtetë, por në gjinoren ajo është thjesht një fjalë e formuar që shënon një marrëdhënie. Ne mund të themi *ljulje dimëri / = lule dimri / e jo kurrë ljulje të dimëri / lule të dimri / sikur të-ja të ishte një nyjë e gjinores*. Ne përkundrazi themi: *ljulje e dimërit / = lule e dimrit /, shi i dimërit / = shi i dimrit* ku të tri fjalët e, i, të të njëvlefshme shënojnë përcaktimin ngushtëzues duke iu përgjegjur *lules së dimrit, shiut të dimrit, të ftohtët të dimrit*; e kështu kemi: *një pjes të meje / = një pjesë të meje /, shkretja e meje / = fatkeqësia ime*. E di se më rëndom thuhet *pjes imia / = pjesë imja / shkretja ime / = fatkeqësia ime /* por braktisja e përemrit është ndryshe nga prishja e tij, sepse *me-ja* nuk është e mundur si përemër yni, por në vend të tij të vihet *meje*, që i afrohet më fort latinishtes.

Ju e pranoni sepse i afrohet «idesë (së tepruar të shprehur prej jush) që ta bësh të quhet shqipen një dialekt të greqishtes». Unë nuk e quaj gjuhën time, siç pohoni ju, si diçka që qëndron o ka qëndruar më vete. Unë mendoj (besoj) se është zhvilluar në një kohë më të lashtë se greqishtja e latinishtja dhe si një motër e madhe mes të dyjave. Të tillë e quaj nëpërmjet arsyetimeve të ndryshme që bëj, por jo sepse e di nga studimet gjuhësore që kam bërë. Nëse kam ndonjë ide për këtë shkencë, këtë e kam në sajë të dy librave që më janë dhuruar me aq fisnikëri nga zotni Komparetti. Por, unë që kam studiuar, me kënaqësi, gjashtë vjet shkencat matematike, nuk më është mbushur mendja për një teori të mbështetur mbi hipoteza a priori nga të cilat me forcë pastaj nxirren përfundime, që vazhdojnë të jenë

të rastit e të kufizuara dhe të kundërshtuara nga të tjera. Unë nuk besoj se gjuha mund të formohet nga përpjekje individuale të bashkëzanuara, as nga përpjekje bashkëkohore të një brezi të vjetër, dhe se ka vajtur gjithnjë e më tepër duke u zhvilluar ku më fort ku më pak; kështu që gjithë këto gjuhë të përfaqësojnë një shkallë të mbarë të zhvillimit të mëpastajmë. Unë besoj se kjo rrjedh nga zvetnimi i një gjuhe më të madhe. Por jo gjithnjë kjo është një teori imja, mbasi unë nuk e di, po e besoj. Dhe nuk e di nëse kjo është teoria që perpiqeni ta kundërshtoni në *Shtojcen e Gramatologjisë*; ku, përkundrazi, shtaqet opinionin im mbi mbeturinat e gjuhës sonë. Nëse keni gjë për të thënë për këtë opinion, uaniet ta shtoni në këtë mënyrë. Gjuha shqipe, siç na është paraqitur nga të huajt që e kanë marrë (nxene) në Shqipëri, është me shumë gabime; nuk ka ose ka më pak se ajo që na është unënë nga shqiptarë të mesuar (të ditur) e që jetojnë në qytetet e tyre të lindjes. Gjuha shqipe duhet të jetë më pak e prisur në ngulimet arbëreshe të Italisë, të mbajtura, të mbyllura ndaj të huajve dhe me fetë e tyre të paprekura, se sa në Shqipërinë e shkelur e të bërë rraish nga turqit. Përmendorja e saj më e kulluar është kënga e kohës së Skënderbeut, që edhe sot ekziston. Kundërshtojeni, po të doni, këtë opinion, por mos e falsifikoni. Ju them veç se, sado fjalë që të harxhoni, nuk do t'i ndërroni faktet, të cilat kanë urdhëruar që, nëse populli ynë do të organizohet (do të ringjallet), do të flasë gjuhën e ngulimeve arbëreshe të Italisë.

Po jua kthej letrën e Tomazeut. Më shkruani nëse do

ta keni marrë këtë dhe nëse princesha Dora d'Istria është gjithnjë në Livorno.

I gëzofshit festat, miku juaj,

Jeronim de Rada

Vula e nisjes së postës:

Morano, Kalabri, më 22 janar 1866

ZEF JUBANIT (NDOKILISË)

Meqë njerëzit ju luftojnë kaq shumë, o bashkatdhetari im, shtëpia ime ju pret si një strehim i hapët, derisa të kalojë stuhia ose derisa të gjeni një punë. Ne, të ikur, të mërguar, sikurse ju, qemë pritur këtu prej të huajsh dhe s'do të njihnim zotin tonë e gjakun tonë, po të mos ju pritnim ju, që vini nga mëmëdheu ynë i bren-gosur.

Me shpresë se do t'ju përqafojmë, nuk ju them tjetër veçse të vini e do të shihni shumë nga ngulimet tona arbë-reshe, ku do të mund të merrni vesh nëse jemi prishur fort, o nëse ruajmë ende disa nga cilësitë, vetitë dhe doket e mira të të parëve tanë.

Jeronim de Rada

Botuar nga Zef Jubani (Ndokilia),
më 12 korrik 1870. Ndoshta letra
e Jeronim de Radës është shkruar para kësaj date.

LARTËSISË SË SAJ, PRINCESHËS ELENA GJIKA

Ideja se mund të hartohej një gramatikë e gjuhës sonë po lindte vetiu në kushtet tona dhe nëse unë e përvetësova, duke qenë shumë i ri, qe, ndoshta, nga ajo që koha e re nxjerr (buron), në mënyrë të vazhdueshme, nga zemrat djaloshare.

Mbasi Lartësia Juaj mori dhe ngriti rishtaz flamurin e Shqipërisë, dhe ndër vëllezër, të ndarë me vend e fe, e shohim tashti të gjithë, si shenjë bashkimi zemrash dhe shpresash, nga të gjitha anët dhe thuajse, instinktivisht, po tregohet kujdes për gjuhën, e cila ka mbetur si mjet i fuqishëm dhe i përbashkët për t'u kuptuar dhe për t'u afruar.

Por kjo, ose e varfëruar nga të këqijat tona, ose e cënuar në fleksionet e veta, duket se nuk e ka më atë që pritet prej saj. Barbarizmat që përdoren në mes njerëzish të largët e të panjohur me njëri-tjetrin dhe që marrin formën e një dialekti, na ngatërrojnë e s'na lënë të merremi vesh mirë. Kështu që ndihet si e domosdoshme që të vihen në pah rregullat e rrepta, në të cilat, ndonëse me ndryshime dialektore, qëndron kjo gjuhë shumë fisnike. Dhe këtë, megjithëse i ri, desha ta bëj duke pasur besim në faktin se isha rritur në kantonin arbë-

resh, që e ruan më mirë veten (1) dhe se kisha lindur nga një nënë gege dhe një babë toskë, i cili kishte mundësi më fort se kushdo tjetër të më ndihmonte në punën time.

Tani, këtë, që unë e desha si ndihmë për bashkimin tonë po e dorëzoj me respekt në duart tuaja, zonja jonë, duke dëshiruar dhe, tashmë nuk e mohoj, që të më pranoni të radhitem si luftëtar për fatin tonë, nën hijen e Flamurit Tuaj.

I shkëlqesisë Suaj,

Shërbëtor i përvujtë

Zef de Rada

1870

ZONJA IME SHUMË E MIRË DHE E NDRITUR

Po përgjigjem me ndonjë ditë vonesë, sepse m'u dësh të jepja me shkrim disa ndriçime mbi një çështje timen civile, për avokatin në gjykatën e madhe të Katanaxaros, dhe, pastaj, sepse u kthye në shtëpi, nga ushtria, im bir. Mbas pak ditësh shpresoj të jem më i qetë.

Ju dëshironi të dini idenë themelore të poemës. Skanderbegu? E, pra, ju do të çuditni për sa do të them. Unë ia nisa dhe shkova përpara duke e thurur pa pasur kurrfarë paramendimi, sepse e ndiej në vetë atë që qe shkruar (në frazën latine); «*Poeta nascitur, orator fit* – Poeti lind, gojëtari bëhet; dhe vonë «*fiti*» filloi të zhvillohet në mendjen time.

Këngët e një pjese të gjatë kohe qenë shprehje të pamposhtura të një ndjenje të tanishme, shumë herë të paraqitura në formën (sipas modelit) e Rapsodive kombëtare, që desha t'i imitoja.

Vetëm kur isha njëzet vjeç fillova t'i bashkërenditja në njëfarë mënyre degët (shkrimet, prodhimet, krijimet) e shpërndara dhe kreuva ciklin e idileve të *Milosaos*.

Atëherë më lindi si parandjenjë ideja për hartimin e një poeme të gjerë, për të cilën *Milosaoja* do të kishte qenë hyrja (tremja) dhe të *Katër historitë*, të botuara

më 1847 – dhe nga të cilat përfitoi Teofil Shtiri – do të sajnin mbylljen e saj.

Tani nuk do të shkoj përtej formës që, në botimin e fundit, i kam dhënë Milosaos. Më vonë do t'ju flas për poemën madhore.

Por, që të vëreni çdo të metë e çdo hijeshi të veprës, të cilën e keni aq për zemër, këtu po ju rreshtoj faktet, nga të cilat lindën (dolën, gjinekuan).

Dhe këtë, me kënaqësinë më të madhe të shpirtit tim, që para se të largohet nga kjo botë do t'ia hapë zemrën një personi kaq fisnik dhe kaq mik për mua, aqsa nuk e meritoj gjithkuj.

Dhe ndoshta, ju do ta kuptoni arsyen pse zoti u tregua kaq i rreptë ndaj jetës sime, mbasi më pat thirrë nga fshati më i përvujtë dhe mbasi më pat nxitur, me mënyra krejt të veta, për të zbuluar gjuhën e traditën stërgjyshore të Shqipërisë së gjorë.

Në Gjermani e në Austri kanë shumë simpati për kombin tim. Dhe për këtë, baroneshë e ndritur, ju jemi shumë borxhlinj juve. Por Franca na njeh, më fort, përmes xhamit të ngjyrosur të helenëve të pabesë.

Prandaj mund ta merrni me mend pritjen dhe respektin plot mirëbesim timin, nëse, duke iu treguar, do të paraqitem, tash, si një fëmijë. Më falni që u zgjata kaq shumë.

Ju puth me respekt dorën

Shumë i devotshmi dhe i detyrueshmi juaj

Jeronim de Rada

28 mars 1884

Letër baroneshës Jozefina Fon Knorr

BARONESHË E NDRITUR DHE SHUMË FISNIKE

Ju uroj pashkët plot kënaqësi, që t'ju sjellin ditë të gëzueshme. Shpresoja t'ju dërgoja numrin e *Fjamurit të Arbërit*, por gjithnjë po vonohet nga pasiguria dhe zemërligësia e vogël e pronarit të shtypshkronjës. Unë s'kam ç'të bëj, sepse asnjë gjethe s'bie, po s'e tha zoti.

Këtu brenda po ju dërgoj tri letrat e rrëfimit tim të përgjithshëm. Do të mund të njihni njeriun dhe shkakun intim (të përbrendshëm) nga format e nga e meta e krijimeve të tij, do të mund të lexoni vargun e sukseseve që e formuan gjatë udhës (krijimit) dhe ta gjykoni ashtu siç është, jashtë botës.

Po ju dërgoj një ekzemplar të *Milosaos*. Po të doni ta kundroni në dritën e gjenezës së saj, dhe nëse do të doni t'ua bëni dhuratë të njohurve tuaj, kam në dispozicion ende shumë kopje dhe nuk besoj se mund t'i vë në përdorim më mirë se sa nga dora juaj e dashur dhe e ditur, e shquara baroneshë.

Më falni për konfidencën e tepruar dhe mos më lini pa lajmet tuaja.

Shumë i devotshmi dhe i detyruari juaj,

Jeronim de Rada

Maqë, ditën e pashkëve të shenjta 1884

Letër baroneshës Jozefina Fon Knorr

I NDRITSHËM ZOTËRI

Letra juaj e papritur, që duhet të më bënte të kërenohesha, më ka turbulluar krejt, mbasi s'kam aspak fuqi t'ju them tani shpejtas gjënë më të vogël për punimin tuaj, si një që nuk e di gjermanishten. Por kam një mik nga Gjermania e Poshtme, profesor muzike në gjimnazin e Koriljanos, i cili s'përton për mua që të m'i përkthejë ai librat gjermanisht, që më interesojnë. Dhe atij i kam dërguar, duke iu lutur shumë, dhuratën tuaj të çmueshme.

Ndërkaq, nuk munda të qëndroj pa u hedhur një sy atyre faqeve, duke u përpjekur t'u diktoj ndërtimin dhe tashmë ia kam kuptuar ndoshta rëndësinë e madhe dhe udhën e drejtë që ju ndiqni, por në të cilën ju do të ndeshni dy pengesa që, ndonëse vijnë duke u pakësuar, nuk lënë që ju të mos hasni vështirësi.

E para është ndryshimi i alfabetëve, të përdorura gjithnjë në mënyrë jo të drejtë, të shumtën e herës nga mungesa e mjeteve të shtypshkronjës dhe shpesh të shtypshkruesve. Kështu, për shembull, *k-ja*, e cila në përdorimin e zakonshëm ka tingullin e fortë të *k-së* latine, nga ana ime që përdorur për të përfytyruar tingullin e butë të *k-së* greke përpara *e-së* dhe *i-së*. Dhe kjo teori imja ju ka shtyrë të përdorni në faqen 19 një ndryshim

dialektor të paqenë në mes të *avëlake-s* sonë dhe *avl'ak'e-s* së Kulluriotit. Nga ana tjetër, mbasi nuk desha që të humbiste pushimi i zërit në pjesët e secilës të më, e shënova me *ë-në* e pazëshme; por, duke qenë se këto pushime janë, thua jse, gjithnjë sapo të dëgjuara, Kullurioti e ka lënë pas dore, edhe unë vetë jo çdo herë e shkruaj dhe prandaj të huajt bien në gabim.

E dyta, është zakon që vërehet menjëherë te shkrimtarët e gjuhës sonë të shprishur e të shpërndarë, që të krijojnë, me anë analogjish gramatikore, fjalët që na mungojnë, në vend që t'i gjurmojnë ku të jenë lënë si të harruara ose të lënë që fantazia krijuese të sajojë asosh nëpërmjet flakës së frymëzimit. Prandaj ai që nuk është shqiptar shpesh ndeshet në krijime vetjake, të marra si thënie popullore. Më tepër se të tjerët, janë plot me këso fjalësh të reja pa themel *Kërshteu i shejtëruar i atë Anton Santorit dhe Kristoforidhi.*

Me këto të meta ka afruar tjetra, që do ta quaja veçori e Kamardës, tek i cili, së pari, zotëroi kryesisht edhe mendimi për të njësuar, mundësisht, shqipen dhe greqishten. Kamarda përpiqet të ndreqë, si mundet, fjalët dhe trajtat gramatikore shqipe në pajtim me sa din ai për to. Le të vlejë si shembull shëmtimi që solli ai në dialektin e Frasnitës, në të cilin, duke i qëndruar pas besnik përkthimit të Sh. Mateut, bërë nga Dorsa, prishte, këtu dhe atje, për ta afruar me atë që nxirrte nga e folmja e Horës së arbëreshëve ose që lexonte në librat dhe në përmbledhjet e bëra nga misionarë ose të tjerë, sipas shqipes së çoroditur të Shqipërisë së Sipërme. Dhe pas tij edhe të tjerë bënë kështu.

Këto dy guma (shkëmbinj të thepisur në ujë) qëndrojnë

para atij që lundron në detin tonë por ju mund t'i shmangni, sikurse më duket se bëni tashmë, duke pasur parasysh burimet e shumta të cilat mbështeteni.

Në të përkohshmen *Fjamuri i Arbërit*, në të cilën vure dorë – dhe nga e cila zotëria juaj shumë e ndritshme ka marrë dy numrat e parë – veçanërisht duhet pasur parasysh që të paraqiten në mënyrë të plotë tingujt e gjuhës, duke shënuar, ku të kemi mundësi, ndryshimet dialektore. Dhe shpresoj se, kur të marrë udhë, ndihma që do të më jepet nga të gjitha anët do të më japë krah për t'ia arritur qëllimit.

Nga librat që nuk përfshihen në katalogun tuaj, nuk njoh të tjerë përveç se *Këngëtoren shqipe* dhe *I burgosuri politik të Santorit*, të rëndësishëm nga vlera estetike dhe *I kërshteu i shenjtëruar*. Unë botova më 1848 *Katër histori (Rrëfime të Arbërit)*, nga të cilat Shtiri përktheu disa faqe dhe më 1843 botova *Identiteti i kombit shqiptar* me pellazgët, në të cilin mitologjia pellazgjike zëbërthehet me anë të gjuhës shqipe. Një botim i dytë qe bërë më 1864. Nga njëri e nga tjetri libër s'kanë mbetur më kopje.

Më në fund, ju lutem të pranoni këtë dhuratë të vogël të një botimi tim të fundit, *Sa liri dhe mirëqenie kanë shtetet me përfaqësi*, libër që s'ka të bëjë me studimet tuaja, por jo pa lidhje me shekullin që po na trondit.

Duke shfaqur plot respekt mirënjohjen time, e konsideroj veten shërbëtor shumë i devotshëm juaj,

Jeronim de Rada

Sh. Mitër Koronë, më 31 tetor 1883

Le'ër Gustav Majerit

I NDRITSHMI DHE SHUMË I NDERUARI ZOTËRIA IM

Fjamuri Arbërit nuk del më mbas numrit të shtatë të vitit të tretë. Më erdh keq, sidomos, sepse u ndërpre botimi i dramës së kallogjer Santorit dhe sepse nuk vërehet më një dëshmitar tjetër i thjeshtë dhe i vërtetë i qenies sonë në vendmërgimin që trashëguam. Por ç't'i bëjmë? Mua më mbeti një kredi e humbur prej më se 2400 liretash nga pajtimtarë detyrues të vonuar dhe nuk pata më nga të miat për t'i përdorur si paradhënie. Mbas dy vitesh që fondet nuk dhanë fryt dhe shitja e pakët ka mbetur e pashitur, dhe qeveria thith dhe bankat tërheqin kapitalet, çdo pasuri këtu është zhdukur. Pardje një pronar, me 400.000 lireta prona toke, nuk pati për të paguar një kambial 100 liretash për farë mëndafshi dhe me vështirësi mundi t'i mbledhë në gjithë Sh. Mitrin, Talerët, që tashmë kanë vajtur keq, janë shitur nga 60 c. libra. Falimentojnë dhe çlirohen nga detyrimet. Dhe rryma, tashmë, po më përpin edhe mua. I zënë ngushtë nga huadhënësit, kam shitur si është më zi grigjën. Dhe tash, tri javë më kot po përpiqem të shes një copë tokë nga më e mira. Dhe nuk gjendet në 3600 banorë, një që të mund të shpenzojë për të mbi 2000 lireta, megjithëqë vlen më tepër. Jam përpje-

kur të shes pronësinë e *Rapsodive kombëtare*, por në Itali, duke përjashtuar pak specialistë që vlejné, të shkruarit quhet një punë kaq e marrë, saqë u jep shkas fare mirë bijve të nëpunësve që, në vend që t'i shpenzojnë të hollat e veta për lexime, t'i përdorin për të kënaqur veset e tyre.

Në këto trazime të pashpresa, po të mos më kishte shkundur letra juaj e dashur, ende do të mbeteshja borxhli ndaj jush. Si pata të përkthyer një pjesë të mirë të *Gramatikës* suaj, dhe, qysh atëherë, mbajta disa shënime, të cilat kam nderin t'jua bashkangjis, ajo që ka mbetur nuk di nëse do t'ju vlejë. Sigurisht sot, ato kujdese që mundojnë zemrën time nuk më lejojnë që të merrem rishtas me të.

Mendimin tim mund ta përmbledh në dy përshtypje: 1) Se ju i pari dhe me fuqi të veçantë, dhe që e keni të vetvetishme, vëreni nga të dhëna të posaçme, ligjet e gjithmbarshme formologjike e sintaktike të gjuhës. Ndoshta shumë përjashtime s'i kapni, por kaq vërshime u bënë, gjatë kohëve në vendburimin e parë, saqë ndryshimet në gjuhën shqipe të shmangen nga mundësia për të bërë çfarëdo përgjithësimi të plotë. 2) Se jo të gjitha burimet nga të cilat keni marrë, janë pa përzierje ose çoroditje.

Unë e quaj të saktë mendimin se shqipja e folur në ngulimet arbëreshe të Sicilisë dhe të Kalabrisë e të Basilikatës, në veçanti, ruan më të pastra ato karakteristika që pati, të paktën në kohën e Skënderbeut. Zotëri Shtiri, që më do aq shumë, më ka dhënë shpresë se do të më nderojë me një vizitë të tijën. Po qe se do ta bëjë në të ardhmen dhe po qe se do të më gjejë gjallë,

— jam 74 vjeç — do ta shohë vetë, në ndarjet në pesë kantone, njëzet e më kilometra larg njeri nga tjetri dhe pa marrëdhënie në mes tyre dhe që megjithatë e kanë të njëjtë morfologjinë dhe sintaksën. Në Sicili do ta gjente të folurën tonë të sinkopuar.

Arbëri i ri u mbyll me numrin e tretë. Shkruanin në të një profesor dhe një student, që jetonin me pensione (me rroga) dhe në Palermon pak a shumë të pasur. Dhe u ra ta shihnin me sy atë që kish thënë Gëtja, se «kush do të njohë mjerimin, le të shkojë në Itali».

Por s'dua t'ju mërzit më dhe me konsideratën më të lartë dhe të nderueshme, e quaj veten si një njeriu Juaj shumë i devotshëm dhe shumë i nderueshëm,

Jeronim de Rada

(janar 1888)

Le ër Gustav Majerit

ZOTËRIA IM I NDRITSHËM DHE I NDERUAR

Kam marrë dhuratën e çmueshme, *Gramatikën tuaj*, dhe mbetem shumë i detyruar, qoftë për vlerësimin me të cilin po më nderoni, qoftë për dashamirësinë me të cilën po e ndihmoni kombin tim të braktisur dhe po ua kujtoni popujve të Evropës. Dje munda t'i dërgoj mikut tim gjerman, në Koriljano, një kopjen, për të më përkthyer ato që më vlejnë më shumë të njoh në të. E pastaj do të jem i gëzuar të bisedoj gjatë me ju. Por, nga sa munda të diktoj, ju po i plotësoni mungesat e paraardhësve tuaj.

Me nderim të ponishëm (të posaçëm), përsëri jam shumë i devotshmi juaj,

Jeronim de Rada

22 maj 1888

Le'ër Gustav Majerit